

Ngritja e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional është një hap i parë drejt forcimit dhe institucionalizimit të Arsimit dhe Formimit Profesional.

Eksperiencia e funksionimit të një Agjencie Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional do të shtrojë rrugën që së shpejti Shqipëria të ketë Autoritetin e saj Kombëtar të Kualifikimeve, në të cilat do të integrohen si kualifikimet akademike ashtu edhe ato profesionale.



AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE E FORMIMIT PROFESIONAL



AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE E FORMIMIT PROFESIONAL

Tiranë, 2007

Rruga: "Naim Frashri"
Nr. 39

E-mail: akafp.tirana@yahoo.com

Qëllimi dhe objektivat e AKAFP

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe e Formimit Profesional është një institucion në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe e Formimit Profesional ka si *qëllim kryesor krijimin e një sistemi kombëtar unik të kualifikimeve profesionale, të njohur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që u mundëson pjesëmarrësve të fitojnë aftësitë/vlerat për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit.*

Në përmbushje të qëllimit, Agjencia nw bashkëpunim me KKAFF synon objektivat e mëposhtme:



- ⇒ Zhvillimi i AFP në lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimit social të vendit.
- ⇒ Sigurimi i partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP.
- ⇒ Integrimi i arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- ⇒ Zhvillimi i dimensionit evropian të AFP duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët evropian.

Në përmbushjen e qëllimit të saj, Agjencia do të ketë funksionet e mëposhtme:

- ⇒ Harton dhe rishikon regjistrin kombëtar të profesioneve, nivelet dhe standardet përkatëse.
- ⇒ Harton dhe rishikon regjistrin kombëtar të kualifikimeve profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse.
- ⇒ Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale
- ⇒ Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale dhe administron regjistrin kombëtar të certifikatave të lëshuara;
- ⇒ Akrediton institucionet e AFP dhe bën licënsimin e tyre për kualifikimet profesionale.
- ⇒ Lëshon certifikatën e kualifikimit profesional për individët.
- ⇒ Siguron që standardet e kompetencave janë në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Europiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Europian të Kreditimit për AFP;
- ⇒ Krijon dhe mban kornizën e trajnimit për mësuesit dhe instruktorët e AFP.
- ⇒ Sigurimi i bashkëveprimit të të gjithë aktorëve kontribues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP.



Tiranë, 2007



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E ARSIMIT
DHE E
FORMIMIT
PROFESIONAL**